



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR**

Nr. 2354/ Prot.

Shkodër, më 18 / 08 /2025

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT**

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

Vendimi Administrativ Nr. 301, datë 28.08.2015 2015 i Degës së Doganës Shkodër ndaj shtetasit "Altin Marku" i datëlindjes **26.11.1993** me numër personal identifikimi **J31126025R** me adrese: Rragam, Komuna Gur i Zi.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës Shkodër

Nr. 2068/11 Prot.

Shkodër, më, 28.08/2015

V E N D I M
Nr.301, datë 28.08.2015

Sot me dt. 28.08.2015, autoriteti vendimarrë i Degës Doganës Shkodër, mori në shqyrtim Proces Verbalin nr 000658, dt 27.08.2015, procesverbalin e kontrollit fizik/verifikimit nr 000828, datë 27.08.2015, akt bllokimin nr 0000393, datë 27.08.2015 të mbajtur nga Grupit të Crown Agents në bashkëpunim me grupet e Antikontrabandës pranë DPD-së, procesverbal për lënien në ruajtje të sendeve dt 27.08.2015, procesverbal mbi sekustrimin e provave material 27.08.2015 të mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore pranë DPD-së, lidhur me konstatimet e bëra për shtetasin Altin Marku, i datëlindjes 26.11.1993, me numer identifikimi personal J31126025R, me adresë: Rragam, Komuna Guri i Zi.

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i mësipërm, rezulton se:

Bazuar në nenin 97 të Ligjin nr 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe bazuar në VKM nr 612, datë 05.09.2012 "Për dispozitat e ligjit të akcizës" e ndryshuar, grupi i Crown Agents dhe grupet e Antikontrabandës kanë ushtruar kontroll në Qytetin e Shkodër dhe kanë konstatuar se në Komunën Guri i Zi, Rragam, ndodhej magazina që grumbullohej, prodhohej dhe përpunohej duhani i grirë.

Nga kontrolli i ushtruar nga autoritet doganore dhe rrethanat e ngjarjes, rezulton se, magazina disponohej dhe përdorej nga shtetasi Altin Marku, me numer identifikimi personal J31126025R, i cili nuk rezulton të ishte i regjistruar në organin tatimor për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik dhe nuk është operator akcize i regjistruar pranë autoriteteve doganore. Nga kontrolli fizik i magazinës, rezultoi të ishin artikujt:

1. 209 kg duhan i grirë pa pullë akcize i paketuar në qese,
2. 69 pako duhan i grirë i paketuar në ambalazh 0,5 kg (gjithësej 34,5 kg),
3. 1 makinë grirëse duhani me korrent,
4. 1 peshore manuale me gurë,
5. 1 gurë zmeril me korrent.

Shtetasi Altin Marku, nuk dispononte asnjë dokument tregtar për të provuar se plotësonte kushtëzimet ligjore për grumbullimin, prodhimin dhe përpunimin e duhanit të grirë, artikuj të cilët i nënshtrohen detyrimeve të akcizës.

Nga sa më sipër, nga autoritetet doganore konstatohet se në gazinën e shtetasit Altin Marku, prodhohej në mënyrë të padeklaruar dhe të pautorizuar (klandestin) duhani i grirë dhe nënproduktet e tij.

Për sa mësipër, autoriteti vendimarrës i Degës Doganore Shkodër gjen të drejtë zbatimin e nenit 85 pika 1 gërma "b", pika 2 dhe nenin 88/1 pika 1 gërma "a, b", pikë 2, 3, 7 dhe 8 të Ligjit nr 61/2012, datë 24.05.2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I

1. Shpalljen debitor të shtetasit Altin Marku, i datëlindjes 26.11.1993, me numer identifikimi përsonal J31126025R, për shmangien nga pagesa e detyrimeve fiskale në shumën prej 1.334.380 lekë dhe gjobë me 5-fishin e detyrimeve fiskale që duheshin prodhuar për mallrat e akcizës në shumën 6.671.900 lekë, **shuma totale 8.006.280 (tetëmilione gjashtë mijë e dyqindetë dhjetë) lekë.**
2. Sekuestrimin e artikujve: 209 kg duhan i grirë pa pullë akcize i pakeluar në qese, 69 pako duhan i grirë i pakeluar në ambalazh 0,5 kg (gjithësej 34,5 kg), 1 makinë grirëse duhani me korrent, 1 peshore manuale me gurë, 1 gurë zmeril me korrent.
Për shkak të procedimit penal të çështjes, artikujt: duhan i grirë pa pullë akcize me peshë 243,5 kg dhe 1 peshore manuale, janë në ruajtje pranë Degës së Doganës Shkodër, ndërsa 1 makinë grirëse duhani me korrent dhe 1 gur zmeril me korrent, për shkak të pamundësisë të cmontimit të tyre, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore janë lënë në ruajtje z. Altin Marku me numer identifikimi përsonal J31126025R.
3. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim në bazë në nenin 105 të Ligjit nr 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



ILIR PRIFTI

KRYETARI